



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:241240

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06349654

C.nr.401/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.G., kundër të paditurit B.S., me vendbanim V, me objekt kontesti rimbursim i dëmit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 10.10.2024, mori dhe me datë 25.10.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses BKS, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET i padituri B.S., që në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 23.03.2017, t'ia rimbursoj paditëses shumën prej 708.00 euro, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga ngritja e padisë (10.07.2019) e deri në pagesën definitive.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja me datë 10.07.2019, ka ushtruar padi në këtë gjykatë kundër të paditurit B.S., me objekt kontesti rimbursim i dëmit.

Pretendimet e palëve

Paditësja përmes padisë dhe gjatë seancave ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e saj në tërësi si e bazuar dhe gjykata ta detyroj të paditurin që si përgjegjës i aksidentit të datës 08.04.2016, ta rimburoj paditësen për kompensimin material dhe jomaterial që paditësja i ka bërë të dëmtuarës nga ky aksident E.M. në shumën prej 708.00 euro. Ka shtuar se deri te aksidenti ka ardhur pasi paditësi i cili ishte duke e drejtuar automjetin-multikultivator, i cili nuk kishte mbulesë siguruese, e ka goditur këmbësoren- të dëmtuarën E.M. dhe për këtë arsye duke u bazuar në nenin 18 par 4, të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (LSDA), përgjegjësia për dëmin bie mbi të paditurin që ka vozitur pa mbulesë siguruese. Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditëses ka theksuar se gjykata duhet ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses sepse pas administrimit të provave është vërtetuar se i padituri e ka shkaktuar aksidentin e datës 23.03.2024.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

I padituri gjatë seancave dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kundërpadinë e paditëses pasi ka theksuar se ai nuk e ka shkaktuar aksidentin e datës 23.03.2017 dhe ka kërkuar që gjykata ta refuzon në tërësi kërkesëpadinë e paditëses. Ka theksuar se i kujtohet se në vendin ku është shkaktuar kanë qenë 50-60 nxënës por që është ndalur tek vijat e bardha dhe më pas është nisur dhe se e dëmtuara dhe babai i saj për 3-4 ditë me radhë pas aksidentit ka ardhur afër urës së gurit në Vushtrri, ku i padituri ka thënë se ka qëndruar në atë kohë me multikultivator së bashku edhe me pronar të tjerë të multikultivatorëve, në pritje të qytetarëve që kanë nevojë për shërbime të punës multikultivatorit dhe e kanë kërkuar shkaktarin e aksidentit por që e dëmtuara në Polici nuk e ka raportuar atë si shkaktar të aksidentit.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova:

- Raporti i policisë i datës: 04.04.2017, me numër 2017-BR-178 për aksidentin e datës 23.03.2017;
- Kërkesa për dem shpërblim e te dëmtuarës me përfaqësues Avokaturën MBN-ës e datës: 20.24.2017;

- Vendimi i komisionit te paditëses se shkalles se pare i datës 25.05.2017;
- Vlerësimi mjekësor nga mjeket censor te paditëses te datës:10.05.2017;
- Raporti mjekësor i QKMF-se ne Vushtrri i datës 23.03.2017;
- Raporti i Qendrës Emergjente i QKUK-se i datës 23.03.2017;
- Vlerësimi i demit jo material nga ana e paditëses e datës 25.05.2017;
- Ujdia jashtë gjyqësore e datës 31.05.2017, e lidhur në mes paditëses dhe E.M., e përfaqësuar nga “Avokatura MBN” Sh.P.K;
- Urdhër transferi i datës 07.06.2017 në shumën prej 708.00 euro nga paditësja te përfituesja E.M., e përfaqësuar nga “Avokatura MBN” Sh.P.K;
- Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares – të dëmtuarës E.M. në Policinë e Kosovës i datës 27.03.2017;
- Dëgjimi i dëshmitares E.M. në shqyrtimin kryesor të datës 03.09.2024;
- Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares – të dëmtuarës E.M. në Policinë e Kosovës i datës 06.09.2024;
- Dosja e Prokurorisë Themelore Mitrovicë e pranuar në gjykatë më datë 10.09.2024 dhe 24.09.2024 së bashku me CD me video incizime;
- Rishqyrtimi i ekspertizës së komunikacionit së ekspertit A.M., e datës 09.10.2024.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe kërkesëpadisë, provave të propozuara si dhe përgjigjes në padi në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në mes palëve nuk ishte kontestues fakti se me datë 23.03.2017, rreth orës 15:15 e dëmtuara E.M ka pasur aksident komunikacioni nga i cili ka pasur lëndime trupore. Kontestuese po ashtu nuk ishte as fakti se e dëmtuara ishte kompensuar për dëmet e pësura në këtë aksident, në shumën e përgjithshme prej 708.00 euro. (Për këtë arsye nuk do të elaborohen raportet mjekësore të së dëmtuarës e as raportin në mes paditëses dhe të dëmtuarës)

Kontestuese në mes palëve ishte nëse i padituri ishte shkaktar i aksidentit të datës 23.03.2017, në të cilin aksident ka pasur dëmtime trupore e dëmtuara E.M..

Nga Raporti policor i aksidentit të trafikut me numër 2017-BR-178, i datës 04.04.2017, është konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur pasi multikultivatori i cili ishte duke u drejtuar nga i padituri, ishte duke lëvizur në rrugën e “Q” në Vushtrri e në drejtim të Spitalit, por me të arritur në afërsi të Shkollës “M.U-2”, me kanatën e rimorkios të anës së djathtë, e godet këmbësoren (të dëmtuarën) e cila ishte në trotuar në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes, ku i shkakton lëndime trupore, ku për natyrën e lëndimeve posedon raportin mjekësor, ndërsa drejtuesi i multikultivatorit vazhdon rrugën duke mos e vërejtur që e ka goditur këmbësoren në fjalë. Tek vendi i skicës, është përshkruar se nuk ka skicë të vendit të ngjarjes sepse multikultivatori është larguar nga vendi i aksidentit.

Nga procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares – të dëmtuarës E.M. në Policinë e Kosovës i datës 27.03.2017, është vërtetuar se e njëjta në Polici ka deklaruar se me datë 23.03.2017 derisa ishte duke shkuar në Shkollën “Sh.M.U-2” dhe po ecte në trotuar, është goditur në krahun e majtë nga një multikultivator me rimorkio, konkretisht me pjesën e djathtë të tij. Ka shtuar se më pas rreth orës 18:00 ka shkuar te mjeku dhe është paraqitur në Polici, ndërsa e njëjta ka theksuar po ashtu se multikultivatori ka qenë me ngjirë hiri, por që nuk ka deklaruar nëse e ka parë personin i cili e ka drejtuar atë mjet transporti. Në fundin e kësaj deklaratë, prindi i saj Z.M., ka deklaruar në Polici se pasi Policia ka shikuar kamerat e qytetit është arritur të identifikohet i padituri dhe se ai personalisht ka biseduar me të paditurin, por i njëjti i ka thënë se “ndoshta e kam goditur vajzën por nuk e kam vërejtur fare” e po ashtu se prindi i të dëmtuarës ka kërkuar nga Policia që ndaj të paditurit të mos iniciohet rast penal sepse i njëjti e ka gjendjen e dobët ekonomike, kurse vajza nuk ka pasur lëndime serioze.

Nga procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares – të dëmtuarës E.M. në Policinë e Kosovës i datës 06.09.2024, është vërtetuar se e dëmtuara është rimarrë në pyetje nga ana e Policisë së Kosovës me datë 06.09.2024 dhe e njëjta ka deklaruar se është aksidentuar në vitin 2017, kur ka qenë nxënëse dhe se ka ndodhur rreth orës 15:00, gjatë kohës kur ka qenë në pushimin e gjatë. Ka sqaruar se ajo ishte në trotuar dhe kishte ardhur një multikultivator, i cili me pjesën e djathtë të rimorkios e kishte goditur atë në krahun e majtë, ndërsa i njëjti ka vazhduar rrugën duke mos u ndalur fare, por që nuk i kujtohet diçka më shumë sepse ka kaluar një kohë e gjatë.

Në dëshminë e saj në seancën e shqyrtimit kryesor të dhënë në cilësi të dëshmitares, e dëmtuara E.M., ka deklaruar se ajo ishte aksidentuar nga multikultivatori i drejtuar nga i padituri para rreth gjashtë viteve. Ka theksuar se pasi ishte goditur ajo nuk e kishte parë se kush e drejtonte multikultivatorin sepse i njëjti ka lëvizur përpara dhe nuk është arritur të identifikohet, mirëpo

Policia përmes incizimeve të kamerave të sigurisë e kanë identifikuar se shkaktuesi i aksidentit ishte i padituri.

Nga Dosja e Prokurorisë Themelore Mitrovicë e pranuar në gjykatë më datë 10.09.2024¹, janë përfshirë edhe këto prova:

- Kallëzimi penal 2017-BR-178, i datës 04.04.2017, I Policisë së Kosovës, me të cilin është theksuar se në bazë të hetimeve në vendin e ngjarjes është konstatuar se këtu i padituri e ka shkaktuar aksidentin e datës 23.03.2017, duke e goditur me pjesën e djathtë të rimorkios të dëmtuarën në krahun e majtë dhe ka vazhduar rrugën duke mos u ndalur fare. Sipas këtij Kallëzimi Penal, identifikimi i të paditurit dhe multikultivatorit të tij, është bërë pas shikimit të disa kamerave në rrugën ku ka ndodhur aksidenti dhe faktit se i padituri e ka identifikuar vetën në këto pamje. Duhet theksuar se në këtë Kallëzim, nuk theksohet se në cilat pamje të kamerave të sigurisë janë referuar dhe nëse në ato pamje është pasqyruar momenti i aksidentit.
- Raporti i oficerit Z.S. , i datës 04.04.2017, në të cilin raport përpos përshkrimit të aksidentit në mënyrë të ngjashme si në kallëzimin penal, është konstatuar po ashtu se Njësia e Hetimeve të Aksidenteve është njoftuar për këtë aksident me datë 27.03.2024 (4 ditë pas aksidentit) dhe menjëherë kanë dalë në vendin ku ka ndodhur aksidenti, ku e kanë fotografuar vendin e ngjarjes si dhe kanë kontaktuar të dëmtaren dhe prindin e saj, nga të cilët kanë marrë nga një deklaratë. Në këtë dosje po ashtu janë edhe katër fotografi të vendit ku ka ndodhur aksidenti dhe katër fotografi të multikultivatorit të të paditurit.
- Kërkesa për dhënien e autorizimit, e datës 29.03.2024, me të cilën Policia ka kërkuar nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, autorizimin për tërheqjen e incizimeve të kamerave të sigurisë nga tri lokale afër vendit ku ka ndodhur aksidenti, konkretisht të lokalit “Real Market”, Objektivit të “QKMF-së” dhe Barnatores “Starfarm”.
- Nga tri kërkesat për veprim hetimor e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të datës 30.03.2017, drejtuar Policisë së Kosovës, nga Prokurori i Shtetit, i është dhënë Policisë

¹ *Sqarim:* Prokuroria Themelore në Mitrovicë, i’a ka dorëzuar gjykatës dosjen penale edhe me datë 24.09.2024, por e njëjta nuk e kishte CD-në e incizimeve të kamerave të sigurisë, prandaj gjykata e ka ripërsëritur kërkesën për CD dhe Prokuroria, ia ka dërguar gjykatës dosjen dhe CD-në, me datë 10.09.2024.

autorizimi për tërheqjen e incizimeve të kamerave të sigurisë të datës 23.03.2017 nga objektet e të lokalit “Real Market”, Objektit të “QKMF-së” dhe Barnatores “Starfarm”.

- Shkresa e Policisë së Kosovës, me titull “Informatë”, e datës 23.03.2017, e rreshterit A.U., përmes së cilës është konstatuar se rreth orës 18:25 minuta është pranuar një informatë në Polici se rreth orës 15:00, ka ndodhur një aksident te afër shkollës fillore dhe Stacionit Policor në Vushtri por që këmbësorja E.M. është paraqitur tek mjeku në momentin e paraqitjes së informatës në Polici (18:25 minuta) dhe se për këtë është njoftuar Prokurori i Shtetit, i cili ka kërkuar që fillimisht të bëhet një hetim plenar e pastaj të shikohet se a ka elemente të aksidentit, e përshkrim i njëjtë është dhënë edhe në raportin e oficerit Musa Kasumi, të datës 23.03.2017.
- Procesverbali i dëgjimit të të dyshuarit B.S., i datës 05.04.2017 në Policinë e Kosovës, në të cilën ai ka deklaruar se me datë 23.03.2017, ka qenë duke lëvizur me multikultivator, ngjyrë të gjelbërt në rrugën e “Q”, në drejtim të stacionit të vjetër të autobusëve, mirëpo i njëjti e ka mohuar se e ka goditur ndonjë këmbësor, duke theksuar se ka parë nxënës në rrugë por që nuk e kishte aksidentuar askënd sepse po ta kishte goditur dikë, ai do të ndalej.
- Akt ekspertimi mjekoligjor, e ekspertes Vesa Kotori, e datës 11.10.2018, me të cilën është konstatuar se në bazë të raportit mjekësor të QKUK-së, të datës 23.03.2017, e dëmtuara ka pasur ndrydhje të indeve të buta të krahut dhe bryllit të dorës së majtë, të regjionit të kërdhollokës së majtë, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mbrehtë, i topitur), i cili lëndim, paraqet lëndim të lehtë trupor me dëmtim të përkohshëm për shëndetin.
- Ekspertiza e komunikacionit, e punuar me datë 05.10.2018 nga eksperti A.M., në të cilën ekspertizë është konstatuar se në bazë të raportit të aksidentit, fotografive të vendit të ngjarjes, deklaratat e tani të paditurit, të dëmturës dhe prindit të saj dhe raporteve mjekësore, është konstatuar se aksidenti i datës 23.03.2017, është shkaktuar për shkak të lëshimeve të paditurit, i cili si drejtues i multikultivatorit, duke lëvizur në rrugën e “Qamerisë”, në drejtim të Spitalit, me të arritur afër shkollës fillore, si pasoj e mos mbajtjes së shiritit gjatë lëvizjes në anën e djathtë të rimorkios e ka goditur këmbësoren e cila ishte në trotuar.

- Nga shikimi i CD-së, është vërtetuar se në të janë ndarë pamjet në tre folder me tituj “Barnatore”, “QKMF” dhe “Real Market”, mirëpo në asnjërën nga këto incizime, nuk ka pamje të momentit të shkaktimit aksidentit në të cilën e dëmtuara E.M., ka pasur lëndime trupore. Në pamjen e folderit “Barnatore”, janë dy incizime, njëra me titull Ch01_20170323143000, në të cilën janë paraqitur pamjet nga ora 14:30:12 e deri në orën 14:58:11, kurse në incizimin tjetër të këtij folderi me titull Ch01_20170323145811, në të cilën janë paraqitur pamjet nga ora 14:58:12 e deri në orën 15:00:01, mirëpo në asnjërën prej tyre nuk ka as pamje të aksidentit e as të ndonjë multikultivatori duke lëvizur në rrugë. Ndërsa në folderin “Real Market”, është vetëm incizimi me titull Ch10_20170323144000, në të cilën janë paraqitur pamjet nga ora 14:40:00 e deri në orën 15:01:00, në të cilat pamje, konkretisht në periudhën kohore 14:46:30 e deri në orën 14:46:39, vërehet duke lëvizur një multikultivator, por që në atë pamje nuk shihet se është shkaktuar ndonjë aksident. Kurse në folderin “QKMF”, nuk ka fare incizime. Gjykata e ka bërë administrimin dhe shikimin e këtyre pamjeve së bashku me palët në seancën e datës 27.09.2024.

Në seancën e datës 27.09.2024, është dëgjuar eksperti i komunikacionit A.M., i cili e ka punuar ekspertizën e datës 05.10.2018, e cila ekspertizë është nxjerrë nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë. Në seancë, eksperti ka deklaruar se konstatimi i dhënë nga ekspertiza e punuar nga ana e tij se aksidenti i datës 23.03.2027, është shkaktuar për shkak të lëshimeve të paditurit, është i bazuar në raportin policor të aksidentit, ngase sipas tij Policia ka qenë në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë fotografitë e rrugës dhe multikultivatorit dhe pasi raporti policor ka përshkruar në detaje pikën e goditjes e po ashtu duke vlerësuar edhe konstruksionit e multikultivatorit, është nxjerrë përfundimi se i padituri ka bërë lëshimi gjatë drejtimit të këtij mjete në momentin e shkaktimit të aksidentit. Eksperti ka shtar se në bazë të raportit policor, Policia ka dalë në vendin ku ka ndodhur aksidenti në ditën kur ka ndodhur aksidenti sepse është përcaktuar koha e aksidentit e po ashtu është bazuar edhe në fotografitë e vendit të ngjarjes, mirëpo ka theksuar se nuk e din se kur janë bërë këto fotografi, kurse faktin se përshkrimi i aksidentit nga ana e Policisë është i saktë, e ka mbeshtetur në atë se ndaj raportit policor të aksidentit, ku janë theksuar lëshimet e të paditurit, nuk ka pasur asnjë kundërshtim nga palët. Në këtë seancë eksperti ka deklaruar po ashtu se në momentin kur e ka përpiluar ekspertizën nuk e ka ditur se për këtë çështje ka edhe incizime të kamerave të sigurisë, prandaj pasi e ka kuptuar këtë ai ka shprehur

gatishmeri se mundet që ta bëj rishqyrtimin e ekspertizës duke u bazuar edhe në pamjet e CD-së së të cilën Prokuroria Themelore në Mitrovicë, i'a ka dorëzuar gjykatës.

Pasi eksperti i komunikacionit A.M., ka përpiluar ekspertizën e komunikacionit për nevojat e Prokurorit të Shtetit, në këtë shqyrtim ka deklaruar se mund ta bëj plotësimin e asaj ekspertize, duke u bazuar edhe në pamjet e CD-së, të cilat nuk i ka pasur në momentin e përgatitjes së ekspertizës, gjykata me pajtimin e palëve ndërgjyqëse, ka kërkuar nga eksperti që ta sqaroj ekspertizën e datës 05.10.2018, në raport me pamjet e CD-së të datës 23.03.2017. Në rishqyrtimin e ekspertizës së ekspertit, të datës 09.10.2024 është konstatuar se eksperti qëndron prapa mendimit dhe konstatimit të dhënë në ekspertizën e datës 05.10.2018 edhe pas shikimit të pamjeve të CD-së dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, e në raport edhe me ekspertizën mjekoligjore se lëndimet janë shkaktuar nga mjeti fortë mbretës.

Eksperti i komunikacionit A.M. lidhur me rishqyrtimin e ekspertizës, është dëgjuar edhe në seancën e datës 10.10.2024, në të cilën seancë ai ka deklaruar se nga shikimi i videoincizimeve në CD, është parë i padituri duke lëvizur, mirëpo në to nuk ka pamje të momentit të goditjes së këmbësore. Eksperti po ashtu ka theksuar se nuk mund ta di se cila është distanca më mes vendit ku ka ndodhur aksidenti dhe vendit në të cilin shihet i padituri duke lëvizur në kamerat e sigurisë e po ashtu se në mes kohës së lëvizjes së të paditurit në kamerat e sigurisë dhe kohës së shkaktimit të aksidentit, dallimi është mbi një (1) orë, si dhe ka shtuar se multikultivatori lëvizë mesatarisht 40 km në orë, ndërsa për një orë ka mundur të lëvizë në një distancë prej 40 kilometrash.

Me nenin 136,1 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD) është përcaktuar që *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, me nenin 137 të këtij ligji është paraparë që *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*, kurse me nenin 960 par 1 të po këtij ligji thuhet se *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguresin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*

Po ashtu me nenin 18 par 4 i Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia parashihet që *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*, kurse me par 4,

të këtij neni thuhet se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*.

Pavarësisht se në këtë çështje nuk ishte kontestuese as për gjykatën se e dëmtuara E.M.me datë 27.03.2017 ka pasur një aksident ashtu që derisa ishte duke ecur është goditur nga një multikultivator dhe se për lëndimet trupore që ajo ka pësuar është kompensuar nga BKS-ja në shumën prej 708.00 eurosh, pas administrimit të të gjitha provave nuk është arritur që të vërtetohet se i padituri është përgjegjës për këtë aksident.

Paditësja përgjegjësinë e të paditurit për këtë aksident e ka bazuar vetëm në Raportin e aksidentit të trafikut me numër 2017-BR-178, i datës 04.04.2017, i cili ka konstatuar se aksidenti është shkaktuar nga i padituri, mirëpo nga administrimi i provave të tjera në këtë proces gjyqësor, është vërtetuar se përshkrimi i aksidentit si në raportin policor, në të cilën të paditurin e bënë përgjegjës është tërësisht i pabazuar dhe i pambështetur në prova. Kjo ngase fillimisht nga Shkresa e Policisë së Kosovës, me titull “Informatë”, e datës 23.03.2017, është konstatuar se për aksidentin e ndodhur rreth orës 15:00, Policia është njoftuar vetëm rreth orës 18:25 minuta, pra pas më shumë se tri (3) orësh pas aksidentit e po ashtu nga Raporti i oficerit Z.S. , i datës 04.04.2017, është vërtetuar po ashtu se Njësia e Hetimeve të Aksidenteve është njoftuar për këtë aksident me datë 27.03.2024 (4 ditë pas aksidentit) dhe pas pranimit të kësaj informate kanë dalë në vendin ku ka ndodhur aksidenti, ku e kanë fotografuar vendin e ngjarjes si dhe kanë kontaktuar të dëmtaren dhe prindin e saj, nga të cilët kanë marrë nga një deklaratë dhe kanë bërë katër fotografitë e vendit ku ka ndodhur aksidenti dhe katër fotografi të multikultivatorit të të paditurit.

Në anën tjetër edhe në Kallëzimin Penal 2017-BR-178, i datës 04.04.2017, nga ana e Policisë aksidenti është përshkruar ashtu siç është përshkruar në raportin policor, por në këtë kallëzim është theksuar po ashtu se pasi ata me datë 31.03.2017 kanë parë disa kamera të sigurisë, e kanë identifikuar të paditurin dhe se edhe i padituri e ka identifikuar vetën dhe multikultivatorin, mirëpo në këtë kallëzim nuk është sqaruar se cilat pamje i kanë parë dhe nëse në to shihet momenti i shkaktimit të aksidentit.

Me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore, gjykata ka siguruar edhe pamjet e kamerave të sigurisë, të cilat i ka poseduar Prokurori i Shtetit, mirëpo nga shikimi dhe analizimi i tyre nuk evidentohet momenti i aksidentit ashtu siç është përshkruar në raportin policor. Pavarësisht se në incizimin me titull Ch10_20170323144000, i cili në këtë CD është në

folderin “Real Market”, në të cilat pamje, në periudhën kohore 14:46:30 e deri në orën 14:46:39 të datës 23.03.2017, vërehet duke lëvizur i padituri me multikultivator, kjo nuk vërtetohet se i njëjti e ka shkaktuar aksidentin në të cilin ka mbetur e dëmtuar E.M.. Lidhur me këtë as ekspert i komunikacionit A.M., në seancën e datës 10.10.2024, nuk ka mundur të identifikoj distancën në mes vendit në të cilin i padituri në këto pamje shihet duke lëvizur dhe vendit të përshkruar në raportin policor të shkaktimit të aksidentit. Për më tepër si në pamjet e folderit “Real Market” (Ch10_20170323144000, në të cilën janë paraqitur pamjet nga ora 14:40:00 e deri në orën 15:01:00) e po ashtu në pamjet e folderit “Barnatore”, (dy incizime, njëra me titull Ch01_20170323143000, në të cilën janë paraqitur pamjet nga ora 14:30:12 e deri në orën 14:58:11, kurse në incizimin tjetër të këtij folderi me titull Ch01_20170323145811, në të cilën janë paraqitur pamjet nga ora 14:58:12 e deri në orën 15:00:01), nuk janë të përfshira pamjet nga ora 15:00-15:15 të datës 23.03.2017, të përshkruar në raportin policor si kohë rreth të cilës është shkaktuar aksidentit.

Për gjykatën përpos që ishte i pabazuar përshkrimi i aksidentit në raport policor, ishte tërësisht i paargumentuar dhe jo bindës edhe konstatimi dhe mendimi i ekspertit A.M. i datës 05.10.2018, të dhënë me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe rishqyrtimi i kësaj ekspertize, i datës 09.10.2024, i cili ekspert është dëgjuar në këtë shqyrtim me datë 27.09.2024 dhe me datë 10.10.2024. Nga dëgjimi i ekspertit në shqyrtimin kryesor është vërtetuar se i njëjti mendimin dhe konstatimin e tij e ka bërë duke u bazuar vetëm në raportin policor të aksidentit e po ashtu edhe nga ekspertiza mjekësore. Mirëpo i njëjti nuk ka pasur njohuri se kur ka dalë në vendin e ngjarjes Policia e Kosovës e po ashtu nuk ka pasur njohuri se cila është distanca në mes vendit ku ka ndodhur aksidenti dhe vendit ku i padituri shihet duke lëvizur me multikultivator. Po ashtu ekspert i komunikacionit ka theksuar se konstatimin e tij e ka bazuar në fotografitë e vendit të ngjarjes ku ka ndodhur aksidenti dhe fotografitë e multikultivatorit të të paditurit, pasi e ka parë konstruksionin e tij, mirëpo i njëjti nuk ka pasur njohuri se në cilën datë janë bërë këto fotografi.

Pasi ekspertiza dhe rishqyrtimi i saj nga ekspert i komunikacionit A.M., e punuar për nevojat e prokurorisë, ishte jo bindëse për gjykatën, në seancën e datës 10.10.2024, gjykata duke vepruar sipas nenit 21 të Ligjit 04/l-118 për ndryshimin e LPK-së, sipas detyrës zyrtare ka caktuar ekspertizën e komunikacionit me ekspert A.Sh. , me detyrat që në bazë të gjitha shkresave të lëndës të përcaktoj nëse i padituri ka qenë pjesëmarrës i aksidentit të datës 23.03.2017 dhe nëse ka qenë, të përcaktohet se a ka pasur lëshime nga i njëjti në komunikacion, të përcaktohet se a ka pasur lëshime nga ana e këmbësorës-të dëmtuarës, të përcaktohet distanca në mes vendit ku

shihet multikultivatori në videoincizim dhe të përcaktoj dallimin kohor në mes kohës në të cilën i padituri shihet duke levizuar në kamerat e sigurisë dhe kohës së përshkruar në raportin e aksidentit se ka ndodhur aksidenti.

Me qëllim të sigurimit të shpenzimeve për këtë ekspertizë, gjykata në kuptim të nenit 451 par 1, të LPK-së, e ka obliguar paditësen që në afatin prej pesë (5) ditësh t'i deponoj në arkën e kësaj gjykate shumën prej 150 euro, duke e paralajmëruar se nëse nuk bëhet deponimi gjykata do të heq dorë nga nxjerrja e kësaj prove dhe do ta revokoj këtë aktvendim. Mirëpo përfaqësuesja e paditëses pas nxjerrjes së këtij aktvendimi, në këtë seancë ka deklaruar se ata nuk do ta bëjnë deponimin e pagesës në emër të shpenzimeve të ekspertizës me arsyetimin se sipas tyre nuk është e nevojshme të nxirret ekspertizë e re. Pas këtij deklarimi të përfaqësues së paditëses, gjykata duke u bazuar në nenin 451.3 të LPK-së, në të cilën dispozitë thuhet se *“Gjykata do të heqë dorë nga marrja e provës në qoftë se shuma e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve nuk deponohet në afatin e caktuar nga gjykata”* gjykata e ka hequr dorë nga nxjerrja e provës me ekspertizë të komunikacionit dhe ka revokuar aktvendimin e datës 10.10.2024, për nxjerrjen e kësaj prove.

Për më tepër edhe vet e dëmtuara E.M., si në dëshminë e saj të dhënë si në Procesverbalin e marrjes në pyetje të dëshmitares – të dëmtuarës E.M. në Policinë e Kosovës i datës 27.03.2017, Procesverbalin e marrjes në pyetje të dëshmitares – të dëmtuarës E.M. në Policinë e Kosovës i datës 06.09.2024, dhe në dëgjimin e saj në cilësi të dëshmitares, e njëjta në asnjërin nga këto deklarata nuk ka deklaruar se i padituri ishte drejtuesi i multikultivatorit i cili e ka goditur atë. Ajo në dëgjimin e saj në cilësi të dëshmitares në këtë proces gjyqësor, ka deklaruar se nuk e kishte parë se kush e drejtonte multikultivatorin i cili e kishte goditur sepse i njëjti ka lëvizur përpara dhe nuk ka arritur ta shoh drejtuesin e automjetit. Dëshmitarja ka deklaruar se faktin se i padituri ka qenë shkaktuar i aksidentit e ka mësuar vetëm nga Policia, të cilët sipas saj, e kanë identifikuar të paditurin përmes pamjeve të incizimeve të kamerave të sigurisë. Mirëpo ashtu siç është theksuar më lartë, incizimet e kamerave në të cilat është referuar Policia në Kallëzimin Penal, nuk kanë pamje të momentit të goditjes por në njërin nga këto incizime (Real Market) është parë vetëm duke lëvizur i padituri, mirëpo ajo rrugë ku shihet i padituri duke lëvizur, sipas ekspertit të komunikacionit i cili e ka përpiluar ekspertizën për nevojat e Prokurorisë, nuk dihet se në çfarë distance ka me vendin ku ka ndodhur aksidentin.

Pasi nga as raporti policor 2017-BR-178 e as ekspertiza e komunikacionit e ekspertit A.M., pamjet e CD-së e as nga dëshmia e të dëmtuarës E.M. , nuk është vërtetuar se i padituri ka qenë

shkaktar i aksidentit, ndërsa në anën tjetër paditësja nuk i ka parapaguar shpenzimet për nxjerrjen e një ekspertize të komunikacionit me detyrat e përcaktuara nga gjykata e të cilat do të kontribuonin në vërtetimin e plotë të gjendjes faktike lidhur me aksidentin e datës 23.03.2017, rezulton se paditësja nuk e arritur të vërtetoj pretendimin e saj se i padituri është përgjegjës për shkaktimin e këtij aksidenti, detyrim ky i përcaktuar me nenin 7 par 1, të LPK-së, ku thuhet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”* dhe nenit 319 par 1, të këtij ligji, me të cilin përcaktohet që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”* Duhet theksuar po ashtu se nga dosja e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, e cila i është dorëzuar gjykatës, është vërtetuar se përpos veprimeve të ndjekjes penale në nxjerrjen e provave, Prokurori i Shtetit nuk ka nxjerr asnjë veprim tjetër të ndjekjes penale për të vërtetuar nëse i padituri ka qenë përgjegjës i aksidentit të datës 23.03.2017.

Përfundimisht gjykata, pas administrimit dhe vlerësimit të të gjitha provave dhe arsyeve të lartcekura, ka arritur në konstatimin se kërkesëpadia e paditëses duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar sepse nuk është vërtetuar me asnjë provë se i njëjti e ka shkaktuar aksidentin e datës 23.03.2017, në të cilin aksident ka pësuar lëndime trupore e dëmtuara E.M., e cila më pas është kompensuar nga paditësja në shumën prej 708.00 euro dhe në këtë kontekst gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses që këtë shumë të cilën paditësja i'a ka kompensuar të dëmtuarës ta paguaj i padituri ngase i padituri nuk mund të detyrohet për një dëm, për të cilin është vërtetuar se ai nuk e ka shkaktuar dhe për këtë arsye ndaj tij nuk mund të zbatohet dispozita e nenit 18 par 4 i Ligjit 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe nenit 960 par 1 të LMD-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës si në dispozitivin III të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale duke u bazuar në nenin 449 dhe 450 të LPK-së.

Andaj nga të lartcekurat, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:241240, C.nr.401/2019, me datë 25.10.2024

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.